



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 251/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Aulona Pol I” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Azizolli” shpk, nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-43935-02-05-2018, me objekt: “Ruajtja e godinës me roje private” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 10 muaj”, me fond limit 5,094,587 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 16.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Berat.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Aulona Pol I” shpk, nga procedura e prokurimit të mësipërcituar.

Autoriteti kontraktor:

Spitali Rajonal Berat.
Adresa: Lagjia “Kushtrimi” Berat.

Ankimues

“AEK Security” shpk
Adresa: Ish-Kombinati tekstileve Berat..

“Nazeri 2000” shpk
Adresa: Rruga “Kavajës”, Qendra Condor, kati II, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.02.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-43935-02-05-2018, me objekt: “Ruajtja e godinës me roje private” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 10 muaj”, me fond limit 5,094,587 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 16.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Berat.

II.2. Në datën 16.02.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit të sipërcituar. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), të cilat janë korrigjuar për gabime aritmetikore dhe pranuar nga operatorët ekonomikë përkatësisht si më poshtë vijon:

1. “Aulona Pol 1” shpk	4,858885.47 lekë	kualifikuar
2. “Nazeri 2000” shpk	4,858885.47 lekë	kualifikuar
3. “Azizolli” shpk	4,859,797.6 lekë	kualifikuar
4. “AEK Security” shpk	4,859,797.65 lekë	kualifikuar
5. “Myrto Security” shpk	4,888,937.52 lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 21.02.2018, operatori ekonomik “AEK Security” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.3.1. Në datën 26.02.2018, operatori ekonomik “AEK Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Aulona Pol 1” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Azizolli” shpk, në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Pasi u njohëm me klasifikimin e operatorëve të shpallur nga KVO e tenderit “Shërbimi i ruajtjes private” të datës 21.02.2018, vumë re se operatori “AEK Security” ishte kualifikuar në vënd të katërt me vlerën 4,859,797.65 lekë në vit. Gjithashtu në vlersimet e tenderit vumë re dy operatorët, konkretisht “Nazeri 2000” dhe “Aulona Pol 1” ishte kualifikuar në vënd të parë me vlerë më të vogël. Konkretisht me 912 lekë më pak në vit. Në vënd të tretë “Azizolli” me 0.05 lekë në vit më pak. Në sqarimin e ofertës së “AEK security”, si dhe në llogaritjen e saj janë përdorur vlerat minimale të faktorëve të shumëzimit. Konkretisht;

-Paga bazë 36000 lekë/muaj ose 206.89 lekë/ora, bazuar në VKM Nr. 399, datë 03.05.2017 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vëndi” dhe Orientimit të APP dhe KPP.

-3 orë vështërsi turni i dytë me 20% të pagës

-8 orë vështërsi turni i tretë me 50% të pagës

Këto bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar

-4.98 koeficienti i zëvendësimit i dhënë nga APP dhe KPP

-30.41 ditë/muaj mesatare e dhënë nga APP dhe KPP

Gjithashtu ne kemi llogaritur sipas kërkesës së DST të Autoritetit afatin prej 304.1 ditë, afat të cilin nuk mund ta ndryshojë askush.

Në këto kushte oferta jonë është llogaritur me parametrat minimale ligjore të mundshëm. Pyesim edhe njëherë; Cilën nga këto vlera mund të ulë ndonjë prej operatorëve?

“AEK Security” është e bindur se vlerat me të ulta të operatorëve të tjerë janë rezultat i mënyrave të ndryshme të kryerjes së asaj që në fakt është i njëjti veprim në minimumin ligjor.

Për këtë po japim një shembull të llogaritjes me faktor të njëjtë, por me rezultate të ndryshme, në saj të rrumbullakimeve dhjetore:

1. Rasti i parë:

Paga minimale ditore 36000:30.41 = 1183.82 lekë në ditë

30.41 ditë/muaj del nga pjestimi me rrumbullakim i 365 ditë : 12 muaj

2. Rasti i dytë:

*Paga minimale ditore 36000*12 muaj : 365 ditë = 1183.56 lekë në ditë*

*Të dy veprimet duken korrekte dhe llogaritëm mbi të njëjtën pagë, por japin rezultat të ndryshëm me 0.26 lekë/roje në muaj. Për 9.96 roje në muaj për 10 muaj, kjo diferencë do të bëhej $0.26 * 9.96 * 10$ muaj = 25.896 lekë në vit.*

Ky është një shembull sesi 2 veprime në dukje ligjore dhe me faktor minimalë të barabartë (paga minimale mujore 36000) jep dy rezultate të ndryshme. Pra në fakt të dy operatorët e paguajnë me pagë minimale rojen, por në mënyrë të padrejtë dhe jo ligjore, duke manovruar nga përafritmet, njëri fiton. KVO e tenderit është e detyruar që pa lëvizur faktorët e shumzimit deh pjestimit ti sjelli veprimet e operatorëve në një standartë dhe më vonë të hedhi short, përndryshme ose pa qëllim shkel hapur ligjin duke u bërë selektiv. Nuk mund të ketë vetëm një fitues, ndërkohë që të gjithë e paguajnë rojen me pagë minimale, vështërsi Turni i II 20%, Vështërsi Turni III 50%, vetëm se dikush na qënka më “i zoti” në manovra aritmetike. Kjo është një shkelje e hapur e ligjit. Shpallja fitues të operatorëve me lojën e presjeve dhjetore është qesharake dhe jo ligjore. Cdo ofertë më e ulët, ose është llogaritur gabim, ose është e paligjshme. Në këto kushte kërkojmë shpalljen e “AEK Security” shpk në vënd të parë si vlerë minimale ligjore e mundshme (së bashku me operatorët të tjerë të barabartë).

II.3.2. Në datën 26.02.2018, me shkresën nr. 424 prot, operatori ekonomik “AEK Security” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.3.3. Në datën 05.03.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “AEK Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Pasi u njohëm me klasifikimin e operatorëve të shpallur nga KVO e tenderit “Shërbimi i ruajtjes private” të datës 21.02.2018, vumë re se operatori “AEK Security” ishte kualifikuar në vënd të katërt me vlerën 4,859,797.65 lekë në vit. Gjithashtu në vlersimet e tenderit vumë re dy operatorët, konkretisht “Nazeri 2000” dhe “Aulona Pol 1” ishte kualifikuar në vënd të parë me vlerë më të vogël. Konkretisht me 912 lekë më pak në vit. Në vënd të tretë “Azizolli” me 0.05 lekë në vit më pak. Në sqarimin e ofertës së “AEK security”, si dhe në llogaritjen e saj janë përdorur vlerat minimale të faktorëve të shumzimit. Konkretisht;

-Paga bazë 36000 lekë/muaj ose 206.89 lekë/ora, bazuar në VKM Nr. 399, datë 03.05.2017

“Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vëndi” dhe Orientimit të APP dhe KPP.

-3 orë vështërsi turni i dytë me 20% të pagës

-8 orë vështërsi turni i tretë me 50% të pagës

Këto bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar

-4.98 koeficienti i zëvendësimit i dhënë nga APP dhe KPP

-30.41 ditë/muaj mesatare e dhënë nga APP dhe KPP

Gjishashtu ne kemi llogaritur sipas kërkesës së DST të Autoritetit afatin prej 304.1 ditë, afat të cilin nuk mund ta ndryshojë askush.

Në këto kushte oferta jonë është llogaritur me parametrat minimale ligjore të mundshëm. Pyesim edhe njëherë; Cilën nga këto vlera mund të ulë ndonjë prej operatorëve?

“AEK Security” është e bindur se vlerat me të ulta të operatorëve të tjerë janë rezultat i mënyrave të ndryshme të kryerjes së asaj që në fakt është i njëjti veprim në minimumin ligjor. Për këtë po japim një shembull të llogaritjes me faktor të njëjtë, por me rezultate të ndryshme, në saj të rrumbullakimeve dhjetore:

1. Rasti i parë:

Paga minimale ditore $36000:30.41 = 1183.82$ lekë në ditë

30.41 ditë/muaj del nga pjestimi me rrumbullakim i 365 ditë : 12 muaj

2. Rasti i dytë:

*Paga minimale ditore $36000*12$ muaj : 365 ditë = 1183.56 lekë në ditë*

*Të dy veprimet duken korrekte dhe llogaritëm mbi të njëjtën pagë, por japin rezultat të ndryshëm me 0.26 lekë/roje në muaj. Për 9.96 roje në muaj për 10 muaj, kjo diferencë do të bëhej $0.26 * 9.96 * 10$ muaj = 25.896 lekë në vit.*

Ky është një shembull sesi 2 veprime në dukje ligjore dhe me faktor minimalë të barabartë (paga minimale mujore 36000) jep dy rezultate të ndryshme. Pra në fakt të dy operatorët e paguajnë me pagë minimale rojen, por në mënyrë të padrejtë dhe jo ligjore, duke manovruar nga përafrimet, njëri fiton. KVO e tenderit është e detyruar që pa lëvizur faktorët e shumzimit deh pjestimit ti sjelli veprimet e operatorëve në një standartë dhe më vonë të hedhi short, përndryshme ose pa qëllim shkel hapur ligjin duke u bërë selektiv. Nuk mund të ketë vetëm një fitues, ndërkohë që të gjithë e paguajnë rojen me pagë minimale, vështërsi Turni i II 20%, Vështërsi Turni III 50%, vetëm se dikush na qënka më “i zoti” në manovra aritmetike. Kjo është një shkelje e hapur e ligjit. Shpallja fitues të operatorëve me lojën e presjeve dhjetore është qesharake dhe jo ligjore. Cdo ofertë më e ulët, ose është llogaritur gabim, ose është e paligjshme.

Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Berat me shkresën Nr. 424, datë 26.02.2018 (dorëzuar tek ne më 28.02.2018) kthen përgjigje e cila është e pasaktë ligjërisht në formë dhe përmbajtjesi mmë poshtë: “Përgjigjia është e firmosur nga KVO e tenderit, gjë e cila shkel VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 78, pika 6, në të cilin specifikohet se në komisionin e ngritur për shqyrtimin e ankesës, nuk duhet të jenë anëtarët e KVO. Kjo e bën përgjigje e autoritetit kontraktor të pavlefshme, pasi KVO-ja ka

grykuar njëherë dhe në si operator ankimojmë pikërisht këtë gjykim. Megjithatë, kjo përgjigje tregon standartin me të cilin ka grykuar ofertat KVO-ja. Në përgjigjen e autoritetit kontraktor na “sqarohet” se në llogaritjen e ofertës sonë ne paskemi marrë parasysh në llogaritje koficientin 30.41 ditë/muaj, dhe se kjo binte ndesh me “Rekomandimet e Shkurtit 2017 të APP dhe KPP”. Gjithashtu përgjigjia e KVO-së thotë se 30.41 ditë/muaj llogaritet vetëm atëherë kur afati është 12 muaj. A thua është në dijeni KVO-ja se në shtojcën 1 (faqja 15) e DST të tenderit kanë kërkuar afat 304.1 ditë pra 10 muaj * 30.41 ditë = 304.1 ditë?!?! Ose 304 ditë e 2 orë e 24 minuta. Pra ne nuk jemi bazuar në asnjë lloj orientimi për afatin e tenderit, përvec DST të tenderit të publikuar nga vetë Spitali Rajonal Berat. Në rast se është dikush që ka shkelur udhëzimet e APP dhe KPP është vetë autoriteti kontraktor. “AEK Security” është e bindur që në mënyrë korrekte, pa asnjë shkelje ka llogaritur në mënyrë minimale të mundshme ligjore të gjitha komponentët e ofertës. Që prej fillimit Spitali Rajonal Berat e botoi këtë procedurë me kriteret të arritshme nga vetëm një operator. Kriteret këto që shmangnin hapur konkurrencën dhe paracaktonin fituesin. Por pas ankimimit të “AEK Security” për këto kriteret autoriteti kontraktor u detyrua ta tërheq procedurën dhe ta rihedh me kriteret e reja. (bashkalidhur ankesa).

Menjëherë pas klasifikimit të operatorëve, pa pritur për afatin e ankimeve të operatorëve, KVO-ja nxitoi të hidhte goglat e shortit ndërmjet 2 operatorëve të parë, veprim i cili bie ndesh me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Po nëse pas ankesave të operatorëve shtohet edhe një operator tjetër me të njëjtën vlerë? Do të rihidhet përsëri short mes 3 operatorëve? Të gjitha shkeljet qesharake të autoritetit kontraktor që prej shpalljes së procedurës, vlersimit të saj prej KVO-së, kthimit të përgjigjes po nga KVO-ja, hedhjes së shortit pa shqyrtuar akoma ankesat, tregojnë se Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Berat në mënyrë sistematike dhe në shkelje flagrante të ligjit po përpiqet të caktojë në mënyrë arbitrare fituesin e kësaj procedure.

Në këto kushte kërkojmë shpalljen e “AEK Security” shpk në vënd të parë si vlerë minimale ligjore e mundshme (së bashku me operatorët të tjerë të barabartë).

II.4. Në datën 21.02.2018, operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 27.02.2018, operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik ekonomik “Aulona Pol I” në procedurën e prokurimit objekt ankimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Nëpërmjet kësaj ankesë duam të bëjmë prezent një problem që konsiston në shkeljet e kryera nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Berat për procedurën e prokurimit të organizuar në datë 16.02.2018 me objekt “Ruajtja e godinës me roje private” si më poshtë: Nga ana e KVO-së në datën 21.02.2018 në mënyrë elektronike është dërguar njoftimi mbi klasifikimin e shoqërive

pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi dhe sipas këtij klasifikimi rezulton se është kualifikuar pa të drejtë shoqëria “Aulona Pol 1” shpk edhe pse nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat e AK sipas DST, për të cilat po ju paraqesim argumentimin tonë si më poshtë:

Së pari: Autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë “Aulona Pol 1” shpk, pasi ka përlllogaritur gabim zërat e shpenzimeve në ofertë. Pasi paga minimale duhej të përlllogaritej sipas VKM nr. 399, ku paga ditore duhej të përlllogaritej në vlerën $36000 \text{ lekë} * 12 : 365 \text{ ditë} = 1183.56 \text{ lekë}$ në ditë për një roje, shtesa turni II sipas nenit 81 të K.P, duhej të përlllogariteshin në vlerën 24.92 lekë në ditë për një roje, shtesa turni III sipas nenit 81 të K.P, duhej përlllogariteshin në vlerën 166.17 lekë në ditë për një roje, dhe sigurime shoqërore sipas VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015, të cilat paguhen në masën 16.7 % lekë në ditë për një roje duhej të përlllogariteshin në vlerën 229.56 lekë në ditë për një roje.

Së dyti: Autoriteti duhet të skualifikojë “Aulona Pol 1” shpk pasi nuk ka përmbushur kërkesën e AK për “Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Berat”. Kjo shoqëri nuk ka përmbushur kërkesën e Ak për certifikata të vlefshme brënda afatit 4 vjecar sipas ligjit nr. 75/2014, neni 5 pika 5, për numrin e kërkuar nga Ak. Shoqëria Aulona nuk ka paraqitur certifikata të vlefshme për Qarkun Berat.

Së treti: Autoriteti duhet skualifikojë shoqëritë “Aulona Pol 1” shpk, pasi nuk plotëson kërkesën shtojca 6, ku AK ka kërkuar “Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit të ketë një vlerë sa 40% e fondit të Marrëveshjes Kuadër. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit” Këto Shoqëri nuk kanë paraqitur vërtetim xhiro për vitin 2017

Së katërti: Autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë “Aulona Pol 1” shpk pasi nuk plotëson kërkesën shtojca 6, ku Ak ka kërkuar dorzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, për plotësimin e kriterit të përgjithshëm për praninë. Kjo shoqëri nuk e ka paraqitur këtë deklaratë.

Së pesti: Autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë “Aulona Pol 1” shpk, pasi nuk plotëson kërkesën shtojca 6, ku Ak ka kërkuar “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”. Pasi kjo shoqëri nuk ka paraqitur vërtetim lëshuar nga OSHE për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë.

Nga argumentimet e bëra sa më sipër kërkojmë nga AK skualifikimin e shoqërisë “Aulona Pol 1” shpk pasi nuk përmbush kërkesat nga Ak në dst.

II.4.2. Në datën 28.02.2018, me shkresën nr. 430 prot, operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 09.03.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 511 prot, datë 12.03.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 413/2, datë 13.03.2018, me shkresën me nr. 540 prot, me datë 19.03.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 453/2, datë 21.03.2018, si dhe me shkresën nr 453/3 prot, datë 28.03.2018, me objekt “*Informacion*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*AEK Security*” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të opertaoreve ekonomik “*Aulona Pol I*” shpk, “*Nazeri 2000*” shpk dhe “*Azizolli*” shpk me arsyen se: “[...] *Janë oferta më të ulëta se kostoja minimale ose janë llogaritur gabim, ose janë të paligjshme. Ndaj kërkohm shpalljen e “AEK Security” shpk në vënd të parë si vlerë minimale ligjore të mundshme (së bashku me operatorët të tjerë të barabartë) [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohes se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....*”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “*1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:*

- a) *anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) *zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) *origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllorëgaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta. Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përllorëgaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.1.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllorëgaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

Public Health Sector

III.1.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve

procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo nësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

2. Ofertuesit ose kandidatin mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogaritur ne dite
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se _____ per 2 dy vend roje me 3 turne	dite	9.96	1682	304.1
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /dite

1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne të llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.9. Ndërkohë në shtojcën 6/2, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 7 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

"7. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)

III.1.10. Në shtojcën 8 "Specifikimet teknike" të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në një vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

Kërkesat për zbatimin e shërbimit

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për SHRSF".

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

III.1.11. Ndërsa në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private” – Marrveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 10 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 10 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit:

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve të nevojshme	Afati i levrimit
2	3	9.96	10 muaj Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 10 muaj.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore, si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni vëren se operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedure prokurimi, kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit, përkatësisht për 1 roje/ditë, për 1 vëndroje me tre turne/ditë- në përputhje me dokumentat e tenderit; ndërkohë që vlerësimi dhe renditja e ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO është kryer mbi bazën cmimit total të kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesit, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi i ofertave të paraqitura të operatorëve ekonomikë “Aulona Pol I” sh.p.k, “Nazeri 2000” shpk dhe konkretisht elementëve bazë të analizës së kostos (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) – elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST, gjykon se operatorët ekonomikë “Aulona Pol I” sh.p.k dhe “Nazeri 2000” sh.p.k nuk kanë respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit, cka do të thotë se edhe shumatorja e ofertave të tyre është nën koston ligjore të lejuar. Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatorët ekonomikë “Aulona Pol I” sh.p.k, e “Nazeri 2000” sh.p.k nuk kanë përmbushur detyrimet bazë për një oferte të sukseshme, siç janë llogaritja saktë e pagës bazë dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këtë qëndrim ka mbajtur KPP edhe në procedura të tjera të ngjashme ku shërbimi është parashikuar të kryhet në më pak se 12 muaj.

Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “AEK Security” shpk, për operatorin ekonomik “Azizolli” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim për të gjithë operatorët ekonomik gjatë kryerjes së korrigjimit të gabimeve arithmetikore, duke mos i trajtuar ata në mënyrë të barabartë, përse i përket korrigjimit të veprimeve arithmetikore.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “AEK Security” shpk, qëndron për operatorët ekonomik “Aulona Pol I” shpk dhe “Nazeri 2000” shpk, dhe “Azizolli” shpk.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “AEK Security”, se ankesa e tij është shqyrtuar nga e njëjta KVO dhe jo nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ashtu siç e parashikon dhe vetë LPP, Komisioni Prokurimit Publik, vëren se

III.2.1. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “ *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*”. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë

29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.” Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”. Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit tëkontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor¹³⁴ i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës. kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 9 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretimin sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re e shqyrtimit të ankesave konkretisht K.Sh. A, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave. Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka dalë jashtë tagrave dhe kompetencave të dhëna nga ligji duke cakuar të njëjtin organ për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave me atë të vlerësimit të ofertave.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k përsa i përket shoqërisë “Aulona Pol I” sh.p.k, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, ky i fundit nuk gëzon më interes të ligjshëm në përputhje me pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi pozitat e këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi nuk do të ndryshonin.

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

III.4. Gjithashtu, nga verifikimet në informacionin e ardhur prane KPP me shkresën me nr. 511 prot, datë 12.03.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 413/2, datë 13.03.2018, me shkresën me nr. 540 prot, me datë 19.03.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 453/2, datë 21.03.2018, si dhe me shkresën nr 453/3 prot, datë 28.03.2018, me objekt “*Informacion*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor, ku rezulton se autoriteti kontraktor në datën 23.02.2018, ora 10:00 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke hedhur shortin për operatorin ekonomik të kualifikuar me vlerë të njëjtë si “*Aulona Pol 1*” shpk, “*Nazeri 2000*” shpk, ku nga rezulton se fitues në shorte është shpallur operatori ekonomik “*Aulona Pol 1*” shpk. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*” Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij*

neni.” Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se hedhja e shortit nga autoriteti kontraktor në datën 29.01.2017 është në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet proceduriale të ankimi brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimues i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatorët ekonomikë ankimues kanë qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë A.K. në momentin e hedhjes së shortit.

III.4.2. Bazuar në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.

III.4.3. Në nenin 28 pika 2 gërma “d” të VKM, nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim; [...]”

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*AEK Security*” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-43935-02-05-2018, me objekt: “*Ruajtja e godinës me roje private*” – *Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 10 muaj*”, me fond limit 5,094,587 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 16.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Berat.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Nazeri 2000*” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomik “*Aulona Pol I*” sh.p.k, dhe “*Nazeri 2000*” shpk , si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke i skualifikuar këta ofertues.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e hedhjes së shortit të mbajtur më datë 23.02.2018, ora 10:00, nga autoriteti kontraktor.
5. Autoriteti kontraktor në rivlersimin e procedurës së prokurimi objekt shqyrtimi, të kryej në mënyrë të barabart për të gjithë operatorët ekonomik që u janë korrigjuar oferrat veprimet arithmetikore.
6. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*AEK Security*” sh.p.k.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 413 Protokolli; Datë 05.03.2018

Nr. 453 Protokolli; Datë 09.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha